

ROLI I KUOTAVE GJINORE NE KESHILLAT BASHKIAKE Rasti studimor Shkodër e Dibër



Ky dokument u prodhua si pjesë e inisiativave publike të pjesëmarrësve të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike” dhe u mbështet nga Akademia e Studimeve Politike. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve synon të sigurojë një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsjelltë të ideve të reja.

Përgatiti:

**Brisela Kadija
Zana Elezi
Adriana Hatellari
Lindita Doda
Lindita Shehu**

Hyrje.....	0
1. PAK KRONOLOGJI MBI ZGJEDHJET PARLAMENTARE DHE LOKALE	0
1.1. Aleancat e grave në nivel qendror dhe shtrirja e tyre ne nivel lokal.....	1
1.2. Aleanca e grave deputete (AGD)	2
1.3. Rrjeti i grave në politikë (RrGnP). Aleanca e grave Këshilltare (AGK).	2
1.4. Karta evropiane për barazi e burrave dhe grave në jetën vendore.....	4
1.5. Impakti i ndryshimit të Kodit Zgjedhor në nivel lokal.....	5
2. METODOLOGJIA.....	5
3. REZULTATET E STUDIMIT	6
3.1. Rasti i qarkut Shkodër.....	6
3.2. Rasti i qarkut Dibër	8
4. PËRFUNDIME	11
5. REKOMANDIME	12
6. BIBLIOGRAFIA	13
7. ANEKS	13

2 HYRJE

Shqipëria është një vend që vitet e fundit është karakterizuar nga rritja e popullsisë në një shifër prej 0.03%¹ dhe kjo i atribuohet më shumë rritjes së numrit të grave në shifrën prej 0.49%¹. Megjithëse numri i popullsisë burra e gra ndryshon pak a shumë në nivele të përafërta, numri i grave të popullsisë shqiptare arrin në një shifër prej 49%¹ përkundrejt shifrës 51%¹ të numrit të burrave.

Ndër vite janë zhvilluar fushata të shumta sensibilizimi lidhur me pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrje dhe nga studimet e realizuara me mbështetjen e faktorëve të huaj është evidentuar se gruaja ka një përfaqësim të ulët në vendimmarrje dhe kjo është vënë re qoftë në qytetet e mëdha, qoftë në zonat rurale. Ky përfaqësim i ulët ka ardhur nga impakti i dobët që shoqëria civile ka patur në lidhje me rritjen e përfaqësimit të gruas në vendimmarrje, por edhe nga fakti se partitë politike shqiptare udhëhiqen nga mentaliteti “burrat janë të lindur për politike”².

Tashmë, 27 vite pas viteve '90 , vite këto të përfaqimit nga shoqëria shqiptare e sistemit demokratik, kuotat gjinore janë një koncept i prekshëm në realitetin politik shqiptar. Këto janë pasojë e një kuadri ligjor të ndryshuar në të cilin është përfshirë koncepti “gender” kudo. Aplikimi i kuotave gjinore luan një rol të rëndësishëm në përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e grave në jetën politike pamvarësisht se suksesi i tyre është i ndryshëm në vende të ndryshme.

Ky kërkim merr përsipër të trajtojë kuotat gjinore në Shqipëri: përfshirjen e grave në jetën politike Shqiptare; aktivizimin dhe kontributin e tyre në komunitet dhe shoqëri, veçanërisht në rastet e përfshirjes së kandidatëve femra në Këshillat bashkiakë; sa ka ndikuar barazia gjinore në vendimmarrje; çfarë ndryshimesh solli ligji i ri i reformës territoriale në përfshirjen e grave në politikë. Ky punim merr përsipër të analizojë nismat e ndërmarra nga gratë e përfshira në politikën vendore. Sa është numri i nismave me ndikim social dhe sa janë implementuar ato në komunitet. Përmes tij, synojmë të nxjerrim rekomandime që do të ndikojnë në rritjen dhe fuqizimin e rolit të gruas në vendimmarrje.

1. PAK KRONOLOGJI MBI ZGJEDHJET PARLAMENTARE DHE LOKALE

Sot, politika shqiptare është një fushë me diferenca gjinore. Kjo kontraston me periudhën komuniste, ku gratë ishin shumë më mirë të përfaqësuara në arenën politike parlamentare edhe

¹ INSTAT “Burrrat dhe gratë në Shqipëri”, 2007

² Leka , M., “ Gratë në politikë dhe politika e burrave” Botuar për herë të parë në gazetën “Shekulli”, 8 Mars 2005, fq.14

pse në realitet, burrat vazhdonin të ishin vendimmarrësit kryesorë. Sipas INSTAT³, parlamenti i vitit 1920 ishte i përbërë vetëm nga burra. Përfaqësimi i grave në jetën politike shqiptare daton në vitin 1945, pasi gratë morën të drejtën e votës. Në rënien e përfaqësimit të grave, në numër, nga vitet '90 kanë ndikuar disa faktorë, ndër të cilët bie në sy paragjykimi socio-kulturor, i cili ndikon kundër zgjedhjes së grave, natyra agresive e politikës, e cila i bën shumë gra të mos angazhohen në politikë, kultura maskiliste e shoqërisë dhe niveli i ulët i vlerësimit të grave. Pas viteve '90, përfaqësimi i grave në politikë ka qënë pothuajse constant. Nuk përbënte as 10% të parlamentit të asaj kohe. Rritja e masës përfaqësuese të grave në politike është vënë re pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009. Kjo erdhi si pasojë e ndryshimit të Kodit Zgjedhor në vitin 2008. Rezultati ishte 23 gra deputete në 140 deputetë në total që kishte parlamenti shqiptar. E përkthyer kjo në përqindje, 16% e deputetëve ishin gra. Megjithëse numri i grave përfaqësuese të forcave politike nuk ka qënë ai i pritshmi. 23 është një shifër që ka pësuar rritje në vitet elektorale që pasuan, 2009 - 2013. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 u vu re se numri i deputeteve femra përfaqësuese të forcave të ndryshme politike kishte arritur në 18%. Në fund të vitit 2016 numri i grave përfaqësuese në parlament arriti në 24% dhe kjo erdhi si pasojë e lënies së mandatit të disa deputetëve dhe zëvendësimit të mandateve të deputetëve burra me gra.⁴ Në zgjedhjet parlamentare të 25 Qershorit 2016, Shqipëria arriti një sukses në lidhje me përfaqësimin e grave në jetën politike. Përqindja e grave parlamentare arriti në 28%. Kjo është shifra më e lartë përfaqësuese e grave në politikë që nga viti 2008, vit në të cilin parlamenti shqiptar miratoi Ligjin për “Barazinë gjinore” si dhe vendosjen e kuotës prej 30% për gjininë më pak të përfaqësuar si dhe përcaktimit të një ndër tre emrat e parë të listës duhet të jetë përfaqësues i gjinisë më pak të përfaqësuar prej grave.

1.1. Aleancat e grave në nivel qëndror dhe shtrirja e tyre në nivel lokal

Gratë e politikës, pjesë e strukturave të partive politike që i përfaqësojnë ato në organe vendimmarrëse, u organizuan në aleanca, rrjete joformale. Organizimi i tyre në këto lloj aleancash ishin fillimisht në nivel qëndror, Aleanca e grave deputete (AGD) dhe më pas u ulën më poshtë, në nivel lokal, Aleanca e grave këshilltare ose ndrysh Rrjeti i grave në politikë (RrGnP).

Aleanca të tilla kanë efekte të shumëfishta: në nivel vetjak, vendor dhe kombëtar, por mbi të gjitha kanë prodhuar një model, i cili mund të ecë përpara i vetëm dhe mund të jetë faktor në procesin e reformës.

Shqipëria ka shënuar progres në lidhje me përfaqësimin e grave në jetën politike shqiptare në këto dhjetë vitet e fundit. United Nations Women (UN Women) me mbështetjen e qeverisë suedeze kanë mbështetur vazhdimisht pjesëmarrjen e grave në politike ashtu sikurse edhe

³ Dragoti, E., Tahsini, I., Dhëmbo, E., Ajdini, J., Monitorimi i hapave të Shqipërisë drejt barazisë gjinore: rasti i kuotave gjinore në politikë, 2011, Tiranë.

⁴ INSTAT, Burrat dhe gratë në Shqipëri, 2017

decentralisation and local development programme (DLDP) pati dhe vazhdon të ketë historitë e saja të suksesit në morinë e lëvizjeve të ndërmarrë për përfaqësimin e grave në jetën politike. Sot aleancat e grave në politikë shërbejnë si një platformë, e cila ka prodhuar rezultate përtej objektivave të programeve.

1.2. Aleanca e grave deputete (AGD)

Që në vitin 2013 deputetet e parlamentit të Shqipërisë janë organizuar në një grupim, pavarësisht përkatësive politike, të quajtur “Aleanca e grave deputete”. Një mbështetje të fuqishme për krijimin e këtij grupimi kanë dhënë: UNW dhe Agjencia e Kombeve të Bashkuara për fuqizimin e grave. Ato u mbështetën në 3 objektiva kryesore⁵:

- Fuqizimin ekonomik të gruas
- Rritjen e pjesëmarrjes së saj në vendimmarrje në nivel qendror dhe lokal
- Luftën kundër dhunës në familje (veçanërisht ndaj grave)

Kjo aleancë ndërpartiake ia ka dalë të ndërmarrë disa nisma ligjore që kanë fuqizuar rolin e grave dhe vajzave në vendimmarrje si dhe ia ka dalë të ofrojë më shumë mbrojtje ligjore për viktimat e dhunës në familje. AGD-ja ka ofruar ekspertizën gjinore në hartimin e ligjeve në parlament me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e grave dhe vajzave. Ndër to mund të përmendim: Kodin e Punës, Projektligjin për birësimet në Republikën e Shqipërisë, Kodin zgjedhor, Shërbimin Social, etj.

Një ndër nismat që ka patur një impakt direkt dhe ia vlen të citohet është ajo e ndërmarrë në ndryshimin e Kodit Zgjedhor në prill të vitit 2015, e cila rriti kuotën e përfaqësimit të grave në listat zgjedhore të zgjedhjeve lokale nga 30% në 50%, por përveç kësaj përcaktoi edhe kriterin tjetër që 1 në çdo 2 emra në listën zgjedhore duhet të ishte grua. Vijimi i mëtejshëm i këtij ligji ishte edhe heqja e gjobës që subjektet politike paguanin në rastin e mosrespektimit të ligjit, duke i detyruar partitë politike që të tërheqin listat në rast se nuk kishin zbatuar kriteret e mësipërme, madje, masa ndëshkuese në rast mosrespektimi mund të arrinte deri në përjashtimin e subjekteve politike nga procesi zgjedhor. Nisma e mësipërme e AGD solli që 35% e këshillave bashkiakë të ishin të përbërë nga grate, krahasuar me 12% që ishin më parë. Po ashtu, njëherazi me AGD-në ishte krijuar një aleance e grave këshilltare në nivel lokal.

1.3. Rrjeti i grave në politikë (RrGnP). Aleanca e grave Këshilltare (AGK).

Rrjeti i grave në politikë (RRGnP) është një rrjet joformal i grave, të cilat janë pjesë e strukturave të partive politike dhe që i përfaqësojnë ato në organe vendimmarrëse si Këshillat Vendorë. Ky rrjet u krijua me nismën e grave këshilltare lokale të Qarqeve Shkodër dhe Lezhë. Që nga viti 2011 RRGnP⁶-ja është mbështetur edhe nga Decentralisation and Local

⁵ <http://www.balkanweb.com/site/aleanca-e-grave-deputete-me-2017-do-kerkojme-te-jemi-50-ne-lista/>

⁶ <http://gp.dldp.al/> u mor nga internet, mw datë 6 Tetor 2017.

Development Programme (DLDP) dhe nga 2015-ta është shtrirë edhe në qarqe të tjera si Durrës, Kukës dhe Dibër.

Në vend që t'i shohë partitë politike dhe politizimin si një sfidë që duhet kapërcyer, nisma e RRGNP-së funksionon brenda sistemit politik për të lehtësuar ndryshimin shoqëror. DLDP-ja i fuqizoi gratë dhe më pas ato u angazhuan në gjenerimin e burimeve publike dhe politikës duke pasur si qëllim përfundimtar përfshirjen sociale.

Ajo çfarë e bën RrGNP-në të shquhet në seritë e lëvizjeve për rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë është qasja novatore e DLDP-së me qëllimin për të ndërtuar një model, i cili të jetë i vetë-qëndrueshëm dhe që mund të replikohet me lehtësi. DLDP-ja zgjodhi qëllimisht krijimin e Rrjetit me synimin për ta integruar gjininë jo përmes projekteve, por nëpërmjet aktorëve të vetë sistemit.

Skema në vijim (Fig.1) shpjegon më së miri se si rrjeti funksionon brenda sistemit politik për të lehtësuar ndryshimin shoqëror.




Fig. 1. Paraqitja grafike e funksionimit të Rrjetit të Grave në Politikë brenda sistemit politik

Ky rrjet përfshin kontributet, ndikimin që ka dhe nivelet e përfaqësimit. Tek kontributet hynë të gjithë imputet që gratë e rrjetit japin dhe marrin për funksionimin dhe përmirësimin e RrGNP-së, të cilat janë trajnime, forumet rajonale, ekspozimi ndërkombëtar, ndarja e eksperiencave etj.

Një ndër imputet / kontributet e arritura nga rrjeti ishte mbështetja deri tani e 18 anëtareve të RrGNP-së në ndjekjen e studimeve në Akademinë e Studimeve Politike, e cila synon të promovojë zhvillimin e brezit të ri të politikanëve dhe liderëve si qytetarë të përkushtuar për zbatimin e modelit demokratik të qeverisjes dhe zhvillimit. Rrjeti ka kontribuar si një platformë shkëmbimi ndërmjet liderëve të rinj dhe grave me përvojë në politikë. Kumtesat e mbajtura nga anëtarët e RrGNP-së janë renditur lart në treguesin e performancës së Akademisë.

Të gjitha këto impute të RrGnP synohen të arrihen përmes një instrumenti novator, siç shihet nga figura 1, i cili çon në; gjenerim të politikave të qeverisjes vendore dhe kombëtare, gjenerim të burimeve publike etj. Ky gjenerim burimesh publike që synojnë zhvillimin e karrierës politike dhe krijimin e hapsirës për konsensus ka ndikim kryesor mbi secilën nga anëtarët e rrjetit. Sot, RrGnP-ja është një rrjet i vetëm, por me efekte të shumëfishta: në nivel vetjak, vendor dhe kombëtar.

1.4. Karta evropiane për barazi e burrave dhe grave në jetën vendore

Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore⁷ është një kartë për organet e qeverisjes vendore dhe rajonale të Evropës. Ajo u drejtohet organeve të qeverisjes vendore dhe rajonale, të cilat ftohen ta nënshkruajnë, të shpallin zyrtarisht përkushtimin e tyre publik ndaj parimit të barazisë së grave dhe burrave dhe të zbatojnë brenda territoreve të tyre angazhimet e parashikuara në të.

Kjo Kartë u hartua në kuadrin e një projekti (2005-2006) të ndërmarrë nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane së bashku me shumë partnerë të tjerë. Projekti u mbështet nga Komisioni Evropian përmes Programit të tij të Pestë të Veprimit Komunitar për barazi ndërmjet burrave dhe grave. Qëllimi i saj është që organet e qeverisjes vendore dhe rajonale, të angazhohen të përdorin kompetencat dhe partneritetet e tyre për arritjen e një barazie më të madhe për banorët e tyre. Për të ndihmuar në zbatimin e këtyre angazhimeve secili autoritet nënshkruar merr përsipër të hartojë një plan veprimi të barazisë, që parashtron përparësitë, veprimet dhe burimet që do të përdoren për këtë qëllim. Përveç kësaj, secili autoritet nënshkruar merr përsipër të bashkëpunojë me të gjitha institucionet dhe organizatat në territorin e tij, me synimin për të nxitur arritjen e një barazie të vërtetë në praktikë.

“Karta Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore” ofron një kornizë për veprimet që synojnë barazinë mes qytetarëve, femra dhe meshkuj, në një sërë fushash. Kjo Kartë është nënshkruar edhe nga disa bashki të Shqipërisë, të cilat i janë bashkuar rreth 1500 Bashkive në Europë. Ata kanë mbështetur përmbajtjen e Kartës njëloj si të gjitha bashkitë evropiane.

Po të shohim dy qarqe që ne kemi marrë përsipër të shqyrtojmë në këtë studim (Shkodër dhe Dibër) duke përfshirë tek secili bashkitë respective, vëmë re se Bashkia Shkodër ka nënshkruar Kartën Evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, në datën 07.03.2017 dhe pikërisht në ditën ndërkombetare të gruas. Me firmosjen se kësaj karte, Bashkia shpreh angazhimin zyrtar për punën në arritjen e barazisë gjinore në nivel politik, ekonomik, social dhe kulturor si dhe respektimin e dispozitave të kësaj karte, të cilat synojnë arritjen e një jete më të mirë për të gjithë popullsinë. Ndërkohë asnjë nga Bashkitë e qarkut Dibër nuk e ka ndërmarrë një nismë të tillë.

⁷(KBRE), Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane, Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, Tiranë 2015

1.5. Impakti i ndryshimit të Kodit Zgjedhor në nivel lokal

Në bazë të ligjit për “Për vetëqeverisjen vendore”, në çdo bashki dhe qark krijohet organi përfaqësues dhe organi ekzekutiv. Organi përfaqësues i bashkisë është këshilli bashkiak. Organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë. Këshilli është autoriteti i veshur me pushtet për të hartuar politika dhe marrë vendime e për të ushtruar të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e këtij niveli të qeverisjes⁸. Këshilltarët duhet të shohin Kushtetutën dhe ligjet në zbatim të saj si dhe ligjin organik, si të vetmit ndërmjetës ndërmjet tyre dhe qeverisë qendrore. Duhet të kemi parasysh se organi kushtetues ka 11 përfaqësues dhe është i zgjedhur direkt me votë nga populli, Këshilli Bashkiak (KB), është organi më i lartë vendimmarrës në organet e qeverisjes vendore.

- **Gratë këshilltare**

Këshilltari bashkiak ka një rol kyç në politikëbërje dhe në marrje vendimesh. Nisur nga kjo, pjesëmarrja e grave në këtë organ është parë si shumë e rëndësishme në orientimin e politikave dhe vendimmarrjes së këshillit në drejtim të perspektivës gjinore. Gratë duket se i njohin më mirë problemet që shqetësojnë komunitetin dhe dinë më mirë rëndësinë e zgjidhjes së këtyre problemeve. Një njësi e qeverisjes vendore (NJQV) si detyrë parësore të saj ka ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe eksperiencat kanë treguar se gratë dinë t’i adresojnë më mirë këto problematika. Tashmë me reformën e re territoriale numri i NJQV-ve është zvogëluar, por numri i anëtarëve të këshillave bashkiakë (KB) është rritur (në kombinim edhe me ligjin elektorale për vendosjen e kuotave). Numri i grave në KB është rritur ndjeshëm, duke bërë të mundur edhe forcimin e rolit të tyre në vendimmarrjen e këshillave bashkiakë. Kjo shihet qartësisht edhe në përpjekjet e tyre për t’u organizuar ndërmjet tyre brenda KB pa dallim ngjyrimi politik për të ndikuar sadopak në vendimmarrjen e KB dhe të kryetarit/res së njësisë së qeverisjes vendore (NJQV-së) në dobi të nevojave të grave dhe vajzave të komuniteteve të tyre. Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2015 u arrit që në nivel vendor të kishim një përfaqësim më të gjerë të grave në vendimmarrje.

2. METODOLOGJIA

Punimi i mëposhtëm është përshkrues / analizues dhe trajtimi tij bazohet në metoda cilësore dhe rasteve studimore në 2 qarqe Shkodër dhe Dibër. Studimi i mëposhtëm është mbështetur në pikat kyçe të mëposhtme;

- Numri i grave pjesë e politikave lokale (vitet 2011- 2015 dhe 2015 e në vazhdim)
- Roli i tyre (në vendimmarrjen lokale).

⁸ Ligji_139_2015_Për_Vetëqeverisjen_Vendore

- Politikat e reja që sollën (me futjen dhe përfshirjen e tyre ne politikë).

Janë analizuar gjetjet cilësore të marra nga rezultatet zgjedhore parlamentare dhe lokale, aleancat e krijuara mes grave parlamentare dhe atyre këshilltare bashkiake, 2011- 2015 dhe 2015 e në vazhdim. Ndërkohë rastet studimore na ndihmuan për të patur një vizion më të qartë të impaktit të kuotave gjinore në komunitetet e bashkive të mëdha përkundrejt atyre të bashkive me numër banorësh më të vogël.

Në fund janë ngritur disa rekomandime që kanë për qëllim fuqizimin e rolit të gruas këshilltare bashkiake në vendimmarrje dhe në nismat që ajo duhet të ndërmarrë në komunitet veçanërisht në nismat me impakt gjinor.

3. REZULTATET E STUDIMIT

3.1. Rasti i qarkut Shkodër

Para zbatimit të reformës administrative territoriale, vitet 2011 – 2015, Qarku Shkodër përbëhej nga 3 rrethe (fig.2); Malësi e Madhe, Pukë dhe Shkodër ku secila përbëhej respektivisht nga :

1. Rrethi Malësi e Madhe përbëhej nga Bashkia Koplík dhe 5 komuna.
2. Rrethi Pukë përbëhet nga 2 bashki: Bashkia Fushë Arrëz, Bashkia Pukë dhe 8 komuna.
3. Rrethi Shkodër përbëhet nga 2 Bashki: Bashkia Shkodër, Bashkia Vau Dejës dhe 15 komuna.




Fig. 2. Paraqitja skematike e e organizimit të qeverisjes vendore viti 2011 – 2015, Qarku Shkodër

Në zgjedhjet lokale të datës 8 Maj 2011 qarku Shkodër pati këtë përfaqësi në nivel bashkie dhe komunash:

Qarku Shkodër 2011 – 2015						
	Bashki	Komuna	Kryetare		Këshilltare	
			Total	F	Total	F
Rrethi M.MADHE	1	5	6	0	98	5
Rrethi PUKË	2	8	10	0	134	9
Rrethi SHKODËR	2	15	17	0	299	28
TOTAL	5	28	33	0	531	42
				0%		8%

Tab1. Tabela e rezultateve të zgjedhjeve lokale të vitit 2011, qarku Shkodër

Në vitet 2011-2015, siç vihet re nga tabela e të dhënave të përpunuara sipas rezultateve të marra nga publikimet e KQZ, qarku Shkodër ka patur në total në të 3 rrethet e tij 0 % fituese gra kryetare bashkie dhe komune dhe vetëm 8 % këshillëtare femra përfaqësuese në nivel vendor.

Ajo çfarë është vënë re në këtë periudhë, nga informacionet e marra është fakt që; gratë në këtë qark të madh, jo gjithmonë kanë votuar për plotësimin e numrit të votave. Përgjithësisht kjo ka ndodhur në këshillat komunal, të cilët kanë patur dominancë meshkujsh, në vlerën 92%.

Çfarë vlen të përmendet për gratë këshilltare të këtyre viteve në qarkun Shkodër është fakti që ato janë nismëtare të krijimit të rrjetit të grave në politikë në vitin 2011, sëbashku me këshilltaret e qarkut Lezhë, rrjet që më pas u shtri edhe në qarqe të tjera.

Tjetër fakt që vlen të përmendet është se gratë këshilltare, pjesë e Komisionit të Arsimit propozuan pasurimin e bibliotekave të 10 shkollave nëntëvjeçare dhe 2 shkollave të mesme me tituj të rinj librash. Bashkia bashkoi fondet me GnP-në (të mbështetur nga DLDP) për të realizuar këtë projekt.

Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2015 qarku Shkodër, ashtu si të gjithë qarqet e tjerë të Shqipërisë, u organizua në një mënyrë tjetër. Me zbatimin e reformës administrative territoriale qarku Shkodër u organizua në 5 bashki të mëdha (fig.3) të cilat patën përfaqësimin e tyre në bashki dhe komuna si mëposhtë (tab.2)




Fig. 3. Paraqitja skematike e e organizimit të qeverisjes vendore viti 2015 – 2019, qarku

Qarku Shkodër 2015 – 2019				
	Kryetarë		Këshillëtarë	
	Total	F	Total	F
Bashkia F. Arrëz	1	0	15	1
Bashkia M. Madhe	1	0	31	7
Bashkia Pukë	1	0	15	3
Bashkia Shkodër	1	1	51	21
Tab.2. Tabela e rezultateve të zgjedhjeve lokale të vitit 2015, qarku Shkodër				
TOTAL	5	1	133	38
		20%		29%

Po të bëhet një vëzhgim i njëjtë si ai mësipër i tabelave të dy viteve 2011 dhe 2015 do të vëmë re se:

- Numri i këshilltareve femra nga 8% që ishte në vitin zgjedhor 2011 u rrit në vlerën 29 % në vitin zgjedhor 2015, pra vëmë re një rritje rreth 4 herë më të madhe se në zgjedhjet pararendëse
- Kryetaret e bashkive femra nga vlera 0% ,që u shpallën fituese në vitit 2011, arritën në një përfaqësim prej 20 % mbas zgjedhjeve lokale të vitit 2015, gjë që tregon rolin dhe rëndësinë që iu dha në këtë periudhë.

Në bazë të të dhënave të marra nga Bashkia Shkodër, e cila nga 51 këshilltarë bashkiakë në total ka 21 femra, rezulton se nga gratë këshilltare është marrë vetëm një nismë më ndikim social dhe gjinor :

Në mbledhjen e tij të datës 24.01. 2016, KB Shkodër, ra dakord me propozimin e Aleancës së grave këshilltare për disa ndryshime të VKB Nr.1 të datës 22.01.2016 për “Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”.

Konkretisht në pikat e mëposhtme të paketës:

II.4.12 Tarifa për shërbimin e kanaleve të ujrave të bardha (KUB) në qytet⁹

Përfshirje për kategoritë tarifave të pastrimit, ndriçimit, gjelbrimit dhe shërbimi i KUB, për individë dhe familje.

Janë grupuar të gjitha përjashtimet për tarifave të pastrimit, ndriçimit, gjelbrimit dhe shërbimi i KUB (për individë dhe familje dhe është saktësuar pika 3 “Kryefamiljarët gra me fëmijë në ngarkim nën 22vjeç). Për këtë kategori vlera që duhet të paguhet do të jetë 50% e tarifës.

Miratimi i një nisme të tillë nga KB pati jehonë në media në atë periudhë.

- Pati impakt pozitiv, sepse në fund të fundit do kishte disa familje që do i zbritej një taksë e caktuar e aq më tepër familje me kryefamiljare gra.

Por kjo nismë e grave këshilltare të KB Shkodër mbeti përgjithësisht në letra, pasi numri i përfitueseve nga reduktimi i kësaj takse ishte shumë i ulët. E gjithë kjo erdhi për 2 arsye;

- Bashkia Shkodër nuk shfrytëzoi të gjitha mjetet e saj të informacionit për të njoftuar shtresat përfituese duke qënë se nuk kishte një sistem të grumbullimit të taksave dhe tarifave vendore që përjashtonte automatikisht këtë kategori.
- Gratë e rrjetit që propozuan nismën, e lanë me aq dhe e quajtën sukses vetëm faktin që kaloi me shumicë votash në KB dhe që realisht ishte një pjesë suksesi, por që duhej të pasohej me pjesën tjetër; infomimin e shtresave përfituese dhe konkretisht grave.

Mbas kësaj date RrGnP-ja nuk ndërmorri ndonjë nisëm tjetër që pati impakt gjinor por mund të themi se ra dakord me propozimet e bëra nga Bashkia Shkodër në lidhje me Buxhetin 2016 dhe 2017 në të cilët kishte qasje gjinore.

3.2. Rasti i qarkut Dibër

⁹ Ndryshime dhe shtesa ne paketen fiskale 2016, Bashkia Shkodër.

Para zbatimit të reformës administrative territoriale, gjatë periudhës 2011 – 2015, Qarku Dibër përbëhej nga 3 rrethe (fig.4): Bulqizë, Dibër dhe Mat, ku secila përbëhej respektivisht nga:

1. Rrethi Bulqizë përbëhet nga bashkia Bulqizë dhe 7 komuna.
2. Rrethi Dibër përbëhej nga Bashkia Peshkopi dhe 14 komuna.
3. Rrethi Mat përbëhej nga Bashkia Burrel dhe Bashkia Klos- Mat si dhe 10 komuna.




Fig. 4: Paraqitja skematike e e organizimit të qeverisjes vendore 2011 – 2015. Qarku Dibër

Në zgjedhjet lokale të datës 8 Maj 2011 qarku i Dibrës pati këtë përfaqësi në nivel bashkie dhe komunash:

Qarku Dibër 2011 – 2015						
	Bashki	Komuna	Kryetarë		Këshilltarë	
			Total	F	Total	F
Rrethi Bulqizë	1	7	8	0	114	6
Rrethi Mat	2	10	11	1	165	10
Rrethi Dibër	1	14	15	0	207	9
TOTAL	4	31	34	1	486	25
				3%		5%

Tab.3: Tabela e rezultateve të zgjedhjeve lokale të vitit 2011, qarku Dibër

Në vitet 2011-2015, siç vihet re nga tabela e të dhënave të përpunuara, sipas rezultateve të marra nga publikimet e KQZ, qarku Dibër ka patur në total në të 4 rrethet e tij vetëm 3% fituese gra kryetare bashkie edhe komune dhe vetëm 5% këshilltare femra përfaqësuese në nivel vendor. Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2015 qarku Dibër u organizua në një mënyrë tjetër (Tab.4).



Fig. 5. Paraqitja skematike e e organizimit të qeverisjes vendore viti 2011 – 2015, Qarku Dibër

Me zbatimin e reformës administrative territoriale qarku Dibër u organizua ne 4 bashki të mëdha, të cilat dhanë edhe rezultatet e mëposhtme në kryetarë bashkish dhe në këshilltarë bashkiak:

Qarku Dibër 2015 – 2019				
	Kryetare		Këshilltare	
	Total	F	Total	F
Bashkia Bulqizë	1	0	21	3
Bashkia Dibër	1	0	31	14
Bashkia Klos	1	0	21	4
Bashkia Mat	1	1	21	4
TOTAL	4	1	94	25
		25%		27%

Tab. 4. Tabela e rezultateve të zgjedhjeve lokale të vitit 2015, qarku Dibër

Po të bëhet një vëzhgim i tabelave të dy periudhave kohore 2011 – 2015 dhe 2015- 2019, për qarkun Dibër, me skemat respektive do të vëmë re se:

- Numri i këshilltareve femra nga 5% që ishte në vitin zgjedhor 2011 u rrit në vlerën 27 % në vitin zgjedhor 2015, pra kemi 22% më shumë femra në KB.
- Kryetarët e bashkive femra nga vlera 3% që u shpallën fituese në vitit 2011 u rrit në vlerën 25% mbas zgjedhjeve të vitit 2015, pra kemi një rritje prej 22% më shumë të përfaqësisë së femrave në drejtimin e bashkive.

Në bazë të të dhënave të marra nga bashkia Klos, e cila nga 21 këshilltarë bashkiakë në total ka vetëm 4 femra, rezulton që nga gratë këshilltare janë marrë një sërë nismash më ndikim social dhe gjinor siç mund të rënditen më poshtë:

- Këshilli i Bashkisë Klos në mbledhjen e tij të datës 19.07.2016 mori në shqyrtim P/Vendimin e kryetarit të Bashkisë Klos dhe te Aleancës së grave këshilltare, diskutoi rreth tij dhe në përfundim vendosi;
 1. Tarifa vendore për vaditjen, për fermerët që mbulohen nga kanali vaditës i Klosit për sezonin vaditës 2016, të jetë 200 lekë/dynym për çdo vaditje;
 2. Të përjashtohen nga tarifa e ujit vaditës gratë K/Familjare.

Në këtë pikë kemi një informacion se numri i grave që përfituan nga kjo nismë është 52 nga 132 që është totali i grave kryefamiljare te veja dhe te divorcuara, pra përfituan 40% e grave. .

-
- Këshilli i Bashkisë Klos, në mbledhjen e tij të datës 22.05.2017 mori në shqyrtim propozimin e aleancës së grave këshilltare, të këshillit të Bashkisë Klos, diskutoi rreth tij dhe në përfundim vendosi:

3. Të bëhet ky ndryshim në paketën fiskale të vitit 2017:

- Për gratë e veja dhe të divorcuara (kryefamiljare), me fëmijë deri 18 vjeç, dhe deri 25 vjeç, kur fëmijët janë studentë, tarifa e druve të zjarrit bëhet 0 (zero).

Në këtë pikë kemi një informacion që numri i grave të veja dhe të divorcuara kryefamiljare është në total 132 gra. Nga nisma e mësipërme përfituan 132 gra dmth 100% .

- Ne VKB nr 158, dt 13.02.2017 "Buxheti 2017", në detajimin e buxhetit, është planifikuar 400 000 lekë, në programin 06140 "Shërbim i kujdesit social për gratë e dhunuara". Vendimi përmbledhës nuk e jep këtë shifër pasi ai ka të ardhura dhe shpenzime në total.

- Më pas Këshilli i Bashkisë Klos¹⁰, në mbledhjen e tij të datës 29.09.2017 mbështetur në bazën ligjore përkatëse mori në shqyrtim Propozimin e Aleancës së Grave Këshilltare të Këshillit të Bashkisë Klos, dhënie ndihme të menjëhershme financiare grave të dhunuara në territorin e Bashkisë Klos gjatë vitit 2017, diskutoi rreth tij dhe në përfundim vendosi;

A. Të miratojë një shumë, fondit i miratuar në Buxhetin e Bashkisë Klos për vitin 2017, i planifikuar për gratë e dhunuara

B. Shuma e miratuar ishte në shifren 400,000 lekë

Në këtë pikë nuk kemi një informacion të saktë se sa përqind e grave të dhunuara përfituan nga ky vendim, por dihet që janë rregjistruar dhe po studiohen 4 raste të grave të dhunuara.

4. PËRFUNDIME

- ✚ Gratë sidomos pas "Kodit Zgjedhor" në Prill të vitit 2015 janë shtuar në numër në këshillat bashkiake. Kemi përfaqësuese politike të reja, të cilat janë nismëtare për të marrë përsipër krijimin, lobimin për miratim në KB dhe implementimin e nismave me impakt social, nga të cilat komuniteti është përfituesi kryesor.
- ✚ Protagonizmi i grave këshilltare ka zbutur disi tonet e ashpra të politikës së dominuar nga meshkujt.
- ✚ Rritja e pjesëmarrjes së grave në këshillat bashkiakë ka rritur interesin për problemet sociale të shoqërisë, pasi ato janë më të vëmendshme dhe më të ndjeshme ndaj tyre, kjo vihet re edhe në rezultatet e këshillave bashkiakë pas përfshirjes së tyre.
- ✚ Gratë brenda këshillave bashkiake kanë krijuar aleancat e tyre, kjo pavarësisht përkatësisë partiake, risi kjo që ka çuar në ndërmarrjen e nismave të përbashkëta në interes të tyre në bindjen e kolegëve të tyre për nismat në ndihmë të grave kryefamiljarë, grave të dhunuara, të trafikuar duke zbutur disa nga problemet më të mprehta sociale të shoqërisë.

¹⁰ Aneks 1, Vendime të KB Klos

5. REKOMANDIME

Në përfundim të këtij studimi sugjerojmë:

- ✚ Të përfshihen dhe të mbështeten gratë në këshillat bashkiake, pasi ato kanë qasje ndryshe ndaj problemeve sociale.
- ✚ Përfaqësimi i grave në Këshillat Bashkiake të shihet si domosdoshmëri dhe jo si një detyrim ligjor për të cilin të shpiken anekse nënligjiore për të rrudhur përfaqësimin e tyre siç po bëhet rëndomë nga partitë politike.
- ✚ Gratë në politikë duhet ta shohin veten dhe të përgatiten profesionalisht, si aktore politike, me një rol të ngjashëm dhe të barabartë me burrat
- ✚ Përfaqësueset femra në këshillat bashkiakë duhet të luajnë një rol më të fortë në forcimin e organeve, grupimeve e lobimeve me gratë dhe për gratë.

6. BIBLIOGRAFIA

- Barazia gjinore dhe vendimmarrja, Përmbledhje artikujsh, Tiranë, Maj 2005
- Burrat dhe gratë në Shqipëri 2017, INSTAT
- Dragoti, E., Tahsini, I., Dhëmbo, E., Ajdini, J. Monitorimi i hapave të Shqipërisë drejt barazisë gjinore: rasti i kuotave gjinore në politikë, 2011, Tiranë
- Forcimi i pushtetit vendimarrës të grave këshilltare në Shqipëri, Raport Studimi, Prill 2015, Tiranë, Shqipëri
- Fuqizimi I grave në politikë
- “Gratë në politikë dhe politika e burrave” Botuar për herë të parë në gazetën “Shekulli”, Leka, M., 8 Mars 2005, faqe 14
- Gratë në lidhshmëri në qeverisjen vendore
- <http://gp.dldp.al/>
- <http://ëëë.panorama.com.al/parlamenti-i-ri-me-numrin-me-te-madh-te-grave-deputete-ne-histori/>
- Karta Evropiane për barazinë e burrave dhe grave në jetën vendore
- Kodi Elektorale (i ndryshuar në 2 Prill 2015),
- Kodi Zgjedhor (i ndryshuar në 2008),
- Kushtetuta e Shqipërisë dhe neneve përkatëse
- Ligjit Nr 139 datë 17.12.2015 Për vetëqeverisjen vendore, Strategjia e barazisë gjinore 2016 – 2020,
- Ndryshime dhe shtesa ne paketën fiskale 2016 , Bashkia Shkodër
- Raport kërkimor, Monitorimi i hapave të Shqipërisë drejt barazisë gjinore, Rasti i kuotave gjinore në politikë, Tiranë 2011.
- Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe plani i veprimit 2016-2020. Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Tiranë, Prill 2016

7. ANEKS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M
Nr 110,dat 19.07.2016

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BSHKISË NR 74,datë 28.01.2016
“PAKETA FISKALE E VITIT 2016”

Këshilli i Bashkisë Klos,në mbledhjen e tijë të datës **19.07.2016**, mbështetur në Ligjin nr 139/2015, Neni 54,shkronja “f”, mori në shqyrtim P/Vendimin e kryetarit të Bashkisë Klos dhe te Aleances se grave keshilltare, diskutoi rreth tij dhe në përfundim me **16(gjashtëmbëdhjetë)** vota pro,

V E N D O S I

1. Tarifa vendore për vaditjen,për fermerët që mbulohen nga kanali vaditës i Klosit,për sezonin vaditës 2016, të jetë 200 lekë/dynim për çdo vaditje.
2. Të përjashtohen nga tarifa e ujit vaditës gratë K/Familjare.
3. Ngarkohen për zbatimin e vendimit strukturat përgjegjesë të Baskisë.
4. Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes, pasi të konfirmohet nga Prefekti i Qarkut Dibër.
5. U shpallë sot me datë 21.07.2016

KRYETARE E KËSHILLIT

Zana ELEZI

Nr. 1420 Prot, datë : 21.07.2016

Konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 656/1, datë 28.07.2016.

Përfituan nga kjo inisiative **52 gra** në atë pjesë të territorit që bashkia e ofron këtë shërbim. Është e vështirë të përllogaritet përfitimi për secilin rast sepse sasia e tokës dhe numri i vaditjeve ndyshon nga rasti në rast. Kostoja për vaditjen e 1 dynym tokë është **200 lek**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË KLOS

V E N D I M

Nr 188, datë 22.05.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË PAKETËN FISKALE TË VITIT 2017

Këshilli i Bashkisë Klos, në mbledhjen e tij të datës **22.05.2017**, në mbështetjen e Ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 54, shkronja “f”, mori në shqyrtim propozimin e aleancës së grave këshilltare, të këshillit të Bashkisë Klos, diskutoi rreth tij dhe në përfundim me **18(tetëmbëdhjetë)** vota pro

V E N D O S I:

1. Të bëhet ky ndryshim në paketën fiskale të vitit 2017:
 - a. Për gratë e veja dhe të divorcuara (kryefamiljare), me fëmijë deri 18 vjeç, dhe deri 25 vjeç, kur fëmijët janë studentë, tarifa e druve të zjarrit bëhet **0 (zero)**
2. Ngarkohet për zbatimin e tij Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe ajo e Infr. dhe Zhvillimit.
3. Vendimi hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes, pasi të shprehet dhe Prefekti i Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.
4. U shpallë sot me datë **25.05.2017**

KRYETARE E KËSHILLIT

Zana ELEZI

Nr.1113. Prot, datë : 25.05.2017

Konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.848/1.Prot. datë 31.05.2017

Nga kjo inisiativë përfitojnë **132 gra**. Është e vështirë të përllgaritet përfitimi për secilin rast sepse nevojat për dru zjarri ndyshojnë nga njëra familje në tjetrën. Kostoja për 1 m³dru në paketën fiskale 2017 është **500 lek**.

Në VKB nr. 158, dt 13.02.2017 "Buxheti 2017", në detajimin e buxhetit, është planifikuar 400000 lekë, në programin 06140 “Shërbim i kujdesit social për gratë e dhunuara”.

Vendimi përmbledhës nuk e jep këtë shifër pasi ai ka të ardhura dhe shpenzime në total.

Nr	Emërtimi	Nr.Fam Gjithsej	Nr. i personave Si Njësi	Nr i Grave Me jetime	Nr. i Grave Divorcuara
1	Njësia administrative KLOS	2,900	10,615	53	9
2	Njësia administrative SUÇ	918	3,400	8	0
3	Njësia administrative GURRË	1,170	4,230	17	4

4	Njësia administrative XIBËR	960	3,422	41	0
	Shuma	5948	21,667	119	13

Kjo shumë do të përpjestohet në fund të vitit duke u nisur nga të dhënat kryesisht të organeve të rendit. Deri tani janë rregjistruar e po studiohen 4 raste. Është menduar që ndihma të jetë ushqimore, strehim, asistencë etj.

Burimi i informacionit: Sektori i Mbrojtjes Shoqërore